



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk II.nr. 1117/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “Segment Kosova” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810871328 dhe seli në Magjistralen Prishtinë-Gjilan, përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve RPHS Law, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 81128747 me seli në Trepçë, Parku Industrial në Mitrovicë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.837/22 të datës 28.04.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Trepça” Sh.A., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.837/22 të datës 28.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, , me aktvendimin e atakuar PPP.nr.827/22 të datës 28.04.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Trepça” Sh.A., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 454/21, i lejuar me datë 22.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr. 454/21, i lejuar me datë 22.10.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.827/22 të datës 28.04.2023.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Segment Kosova” Sh.P.K., me dt. 22.10.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës FSH00774, të datës 28.07.2021, ka lejuar urdhrin përmbarimor P.nr. 454/21, të datës 22.10.2021, me të cilin është urdhëruar debitori “Trepca” Sh.A., që në afat prej 7 ditësh, shumën prej EUR 6,406.66 sipas dokumentit të besueshëm me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e arritjes për pagesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet në emër të përfaqësimit nga avokati në vlerë prej EUR 104.

Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.454//21 dt. 22.10.2021 e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se në dokument mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk përmban kohën e përmbushjes së detyrimit, çka e bënë atë të papërshtatshëm për përmbarim. Gjykatës i ka propozuar që urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Kreditori, nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.827/22 të datës 28.04.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Trepça” Sh.A., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 454/21, i lejuar me datë 22.10.2021, nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj, ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr. 454/21, i lejuar me datë 22.10.2021.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën nr. FSH00774, të datës 01.07.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është furnizuar debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe afati për përmbushje. Po ashtu, gjykata vlerëson dokumenti i besueshëm – fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali. dhe mbanë nënshkrimin e pranimin nga ana e debitorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton

se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbardim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 në par.1.17 parasheh që “Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohet si dokument i besueshëm. Po ashtu, fatura është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali. dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbasin të pabazuara pasi nuk ka arrit të argumentoj me prova juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbardimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbardimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbardues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbardimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1117/23 me datë 05.03.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami